



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 188, Datë 17/12/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën nr. 73, datë 25.06.2019, e Znj. S. L., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Aleat sh.p.k. pranë Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe nr. 7, në Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas ankuesit.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se në datën 24.06.2019, Znj. S. L., e cila është me aftësi të kufizuara<sup>3</sup> është paraqitur për të kryer aplikimin për t’u pajisur me pasaportë, pranë zyrave të Aleat sh.p.k, për Njësinë Bashkiake nr. 6 dhe nr. 7, në Tiranë. Ankuesja pretendon se vendi i aplikimit kishte shkallë nga të gjitha anët dhe asnjë rampë për të siguruar aksesin e saj në zyrat përkatëse. Znj. S. L. sqaron se, ndërkohë që babai i saj shprehu shqetësimin lidhur me sa më sipër, u gjend përballë me arrogancën e punonjësës që mbante vulën e Minibashkisë, e cila i thotë se duhet të kishte marrë masa për të marrë njerëz me vete, për të ngritur karrocën me rrota të së bijës. Ankuesja u transportua për në zyrat e aplikimit, me ndihmën e personave, që u gjendën aty pranë.

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën “LMD”.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën “KMD”.

<sup>3</sup> Referuar Librezës së Identitetit “Për përfituesit e Statusit të Invalidit Paraplegjik e Tetraplegjikë”.

Në vijim, ankuesja pretendon se u ndesh me paaftësinë e stafit, që merrej me procedurat përkatëse. Operatorët insistonin për marrjen e shenjave të gishtërinjve të saj, ndërkohë që një gjë e tillë ishte e pamundur, për shkak të dëmtimeve të saj, fizike. Znj. S. L. thekson faktin se edhe në aplikime të mëparëshme, marrja e shenjave të gishtërinjve ka qenë e pamundur. Ajo shprehet se insistimi i njërit prej operatorëve, ishte i tepruar, duke shkelur integritetin e saj, fizik. Vetëm pas insistimit të saj, personat përgjegjës komunikuan me eprorët e tyre, të cilët i qartësuan mbi procedurat, që duheshin ndjekur në raste të tilla.

Përveç sa më sipër, ankuesja pretendon se ambienti, ku kryhej aplikimi për pasaportë ishte shumë i ngushtë dhe jo i mobiluar sipas standardeve të përshtatëshme, për personat me aftësi të kufizuar. Stafi i Aleat sh.p.k. nuk menaxhonte rradhën në mënyrën e duhur dhe nuk kishte prioritet për personat me aftësi të kufizuar.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 73, datë 25.06.2019, e Znj. S. L., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1044, datë 01.07.2019, Aleat sh.p.k. pranë Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe nr. 7, në Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë dhe për dijeni ankuses, ku kërkohej informacion, mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.
  - Në përgjigje të shkresës nr. 1044, datë 01.07.2019, së Komisionerit, Aleat sh.p.k. dërgoi shkresën nr.1017/4, datë 06.08.2019, nëpërmjet së cilës informon se invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë u kushtohet një kujdes i veçantë, përgjatë kryerjes së procedurave për aplikimin për pasaporta, duke u krijuar lehtësira në këtë proces dhe duke garantuar mbrojtje efektive nga diskriminimi.

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Aleat sh.p.k. sqaron se është tepër e rëndësishme për prodhimin e dokumenteve identifikuese, që marrja e shenjave të gishtërinjve në zyrat e aplikimit, të kryhet me kujdes dhe në përputhje me procedurën e parashikuar për prodhimin e këtyre dokumenteve. Nëse shenjat e gishtërinjve nuk do të merreshin saktë, atëherë do të përsëritej aplikimit në një tjetër qendër të Aleat sh.p.k., brenda të njëjtës ditë.

Në shkresën e sipërpërmendur theksohet fakti se regjistrimi i mirë i gjurmëve të gishtërinjve është domosdoshmëri, duke pasur parasysh faktin, që pas kryerjes së aplikimit, të dhënat personale të regjistruara ngarkohen në sistemin Aleat, i cili verifikon saktësinë e kapjes së këtyre të dhënave personale. Në rast se shenjat e gishtërinjve nuk janë marrë dhe regjistruar në mënyrën e duhur, sistemi nuk do të jetë në gjendje të verifikojë dhe njehsojë këtë informacion dhe si rrjedhim dokumenti identifikues nuk do të jetë e mundur të lëshohet.

Në rastin e Znj. S. L., punonjësit e Aleat sh.p.k. kanë hasur vështirësi të konsiderueshme për të regjistruar gjurmët e gishtërinjve, si pasojë e djersitjes dhe dridhjes së duarve të aplikantes. Për këtë arsye, ka qenë e nevojshme që punonjësit e Aleat sh.p.k. t'i kushtojnë vëmendje të veçantë dhe të insistojnë në regjistrimin me tepër kujdes të shenjave të gishtërinjve të saj. Sikurse u përmend edhe më sipër, është në interesin e aplikantit që shenjat e gishtërinjve të merren saktësisht gjatë aplikimit, në mënyrë që të evitohet një aplikim i dytë, brenda së njëjtës ditë, në një qendër tjetër të Aleat sh.p.k., fakt, që do të rezultonte tepër lodhës për Znj. S. L..

Duke marrë parasysh sa më sipër, Aleat sh.p.k. thekson faktin se në asnjë lloj rrethane, nuk mund të bjerë dakord me sjellje, që mund të shkaktojnë cënimin e integritetit fizik të aplikantit. Përkundrazi, punonjësve të Aleat sh.p.k. u është kërkuar të sillen profesionalisht dhe me kujdesin më të madh me të gjithë aplikantët gjatë zbatimit të procedurave të aplikimit. Për këtë arsye, Aleat sh.p.k. sqaron se sjellja e punonjësve të Aleat sh.p.k., që është interpretuar nga ankuesja si cënim i integritetit të saj, fizik, ka qenë një përpjekje e tyre për të kapur e regjistruar në mënyrën e duhur, shenjat e saj të gishtërinjve. Një gjë e tillë është kryer për ta asistuar në aplikim, por në asnjë rast për të cënuar integritetin e saj, fizik.

Lidhur me pretendimin e ankueses se zyra e Aleat sh.p.k. ishte shumë e ngushtë dhe nuk plotëson kërkesat për një person me aftësi të kufizuara, në shkresën e kësaj shoqërie sqarohet se Aleat sh.p.k. e ushtron aktivitetin e tij në një zyrë brenda ndërtesës së Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, në përputhje me parashikimet e Kontratës së Konçesionit.

Në shkresë theksohet fakti se zyra e aplikimit për pasaporta e Aleat sh.p.k. ndodhet brenda godinës së Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, në Tiranë, ndërtesë, kjo që përdoret për shumë shërbime dhe zyra që përdor Aleat sh.p.k. konsiton vetëm në një pjesë të godinës. Për këtë arsye, përgjegjësia për ngritjen e rampave nuk është e Aleat sh.p.k., por e pronarit të ndërtesës.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, nëpërmjet Urdhërit nr. 138, datë 05.08.2019, të Komisionerit “Për kryerjen e inspektimit pranë zyrave të Aleat sh.p.k. pranë Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, për verifikimin e pretendimeve të ankueses S. L.”, inspektorët e KMD-së u paraqiten për inspektim pranë godinës së Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, për të kryer verifikim të drejtpërdrejtë të zyrës respektive të Aleat sh.p.k.

Objekti i inspektimit konsistonte në çështjet e mëposhtme:

1. Kryerja e verifikimeve të drejtpërdrejta në ambientet e Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, përkatësisht në zyrat e Aleat sh.p.k., ku shtetasit shqiptarë aplikojnë për pasaporta, lidhur me kushtet e krijuara për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në këto zyra;
2. Informacion lidhur me procedurat e ndjekura, në pamundësi të marrjes së shenjave të gishtërinjve të aplikantëve, si rrjedhim i dëmtimëve të tyre fizike. Administrimi i një kopje të manualit, ku përcaktohen këto procedura;
3. Informacion, nëse individëve me aftësi të kufizuara u jepet përparësi, në rastet kur radha e aplikantëve për pasaportë pranë zyrave respektive është relativisht e gjatë.

Me paraqitjen e tyre pranë godinës Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, Tiranë, inspektorët e KMD-së u informuan se zyra e Aleat sh.p.k. ishte transferuar prej disa muajsh në një ambient të ri tek Pallati me Shigjeta. Në vijim, inspektorët e KMD-së u paraqiten pranë ambientit të ri, ku zyra e Aleat sh.p.k. ushtronte funksionet e saj. Nga verifikimi i drejtpërdrejtë i kryer në këtë ambient dhe rrethinat e tij, u konstatua se për të patur akses në zyrën e Aleat sh.p.k, duheshin ngjitur disa shkallë, fakt që e bënte të domosdoshme ekzistencën e rampës për të siguruar aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuara. Nga verifikimi i kryer u konstatua mungesa e rampës, që siguron akses të individëve me aftësi të kufizuar pranë Zyrës së Aleat sh.p.k.

Në vijim, inspektorët e KMD-së kontaktuan me punonjësit e Aleat sh.p.k., të cilëve iu kërkua informacion mbi çështjet që përbënin objekt inspektimi. Infomacioni i kërkuar në Urdhërin e inspektimit u dha nga operatori i regjistrimit M. M., i cili në lidhje me pikën 2 të objektit të urdhërit të inspektimit u shpreh se marrja e shenjave të gishtërinjve kryhej sipas një manuali të posaçëm të shoqërisë. Z. M. M. iu kërkua një kopje e këtij Manuali, por në kushtet kur, ai sqaroi se nuk ishte i autorizuar nga ana e titullarëve të Aleat sh.p.k, inspektorët nuk arritën të merrnin në administrim një kopje të këtij dokumenti. Në lidhje me pikën e tretë të objektit të urdhërit të inspektimit, z. M. M. u shpreh se nuk kishte ndonjë orientim zyrtar nga ana e Aleat sh.p.k., lidhur me dhënien përparësi të aplikantëve me aftësi të kufizuar, por gjithësesi punonjësit e kësaj zyre trajtonin me prioritet, kur kishte rradhë të gjata, jo vetëm personave me aftësi të kufizuar, por edhe të moshuarve.

Në kushtet kur, inspektorët e KMD-së u gjendën para faktit që zyrat e Aleat sh.p.k. nuk ndodheshin brenda godinës së Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, por në katin e parë të Pallatit me Shigjeta, u kërkua informacion mbi periudhën kur kishte ndodhur transferimi. Z. M. M. informoi se transferimi i zyrës së

Aleat sh.p.k. kishte ndodhur në muajin shkurt 2019. Inspektorët e KMD-së kërkuan informacionin vijues mbi këtë çështje dhe specifikisht një kopje të kontratës së qerasë për këto ambiente, për të identifikuar dhe evidentuar palët kontraktuese. Z. M. M. u shpreh se nuk kishte informacion mbi këtë çështje, ndaj u ra dakord që ai të kontaktonte me eprorët e tij dhe të dërgohej zyarisht pranë KMD-së informacioni i mëposhtëm:

- Kopje e Manualit të Aleat sh.p.k., ku përcaktoheshin procedurat për marrjen dhe regjistrimin e shënjave të gishtërinjve të aplikantëve për pasaportë;
- Kopje e kontratës së qerasë për ambientet e marra me qera në Pallatin me Shigjeta, ku ushtron funksionet zyra e Aleat sh.p.k. për Njësinë Bashkiake nr. 6 dhe 7.
- Kopje e Kontratës/Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Shoqërisë Aleat sh.p.k.

1. Në vijim, Aleat sh.p.k. dërgoi në adresë të KMD-së, fillimisht shkresën nr. 1017/4, datë 06.08.2019 dhe në vijim të inspektimit, shkresën nr. 1255, datë 21.08.2019.

Mbështetur në shkresën e fundit të dërguar nga Aleat sh.p.k., kjo shoqëri e informon Komisionerin se Aleat sh.p.k. nuk ka ndonjë kontratë qiraje me Bashkinë Tiranë, për të përdorur ambientet e Minibashkisë nr. 6 dhe 7, Tiranë, por ambientet ku kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj, i janë dhënë në përdorim nga Ministria e Brendshme, mbështetur në parashikimet e Kontratës së Konçesionit të lidhura ndërmjet tyre, në datën 21.07.20108, (e ndryshuar).

Aleat sh.p.k. e informon Komisionerin, se në cilësinë e autoritetit kontraktor, Ministria e Brendshme ka përgjegjësinë për të vënë në dispozicion të Aleat sh.p.k., ambientet përkatëse, në përputhje me Kodin e Punës dhe kritere të tjera lidhur me sigurinë, aksesin, etj. në vendin e punës. Këto ambiente ndodhen në zyrat administrative rajonale dhe zyrat e gjendjes civile, godinat e së cilave, kjo ministri i ka në pronësi ose përdorim. Këto ambiente e kanë vendndodhjen brenda zyrave të gjendjes civile dhe përdoren nga Aleat sh.p.k. si zyra aplikimi. Në shkresë theksohet se në bazë të Kontratës së Konçesionit, zyrat sigurohen nga autoritetet shqiptare.

Në shkresë ritheksohet fakti se Zyra e Aplikimit të Aleat sh.p.k. pranë Minibashkisë nr. 6 dhe 7 ndodhet brenda një ndërtese publike, që kryen shumë shërbime, dhe vetëm një pjesë e këtyre ambienteve është dhënë në përdorim nga Ministria e Brendshme, për Shoqërinë Aleat sh.p.k.

Për sa më sipër, Aleat sh.p.k. thekson faktin se nuk ka përgjegjësi për vendosjen e rampave në zyrat e minibashkive, ku kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj, pasi Aleat sh.p.k. i janë dhënë në përdorim këto ambiente, nga ana e Autoritetit, konform Kontratës së Konçesionit dhe aksesit për këto ambiente përdoret gjithashtu për disa shërbime të tjera publike, si p.sh. shërbimet e gjendjes civile.

Aleat sh.p.k. dërgoi bashkëlidhur shkresës së tij një kopje të Manualit, në lidhje me procedurat që ndiqen për aplikimin për dokumente identifikimi.

**D.** Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 17.09.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, e cila siguron aksesueshmëri fizike për ankesën S. L..

Përfaqësuesit me autorizim të institucioneve palë në proces, iu kërkua të depozitojnë në seancë dëgjimore, aktet e mëposhtëme:

- Kopje të Kontratës së Shërbimit/Aktmarrëveshjes përkatëse, së lidhur ndërmjet institucionit përgjegjës dhe Aleat sh.p.k, nëpërmjet së cilës kjo e fundit ushtron funksionet e saj, duke ofruar shërbimet përkatëse ndaj shtetasve të saj;
- Kopje e Kontratës së Qerasë, së lidhur ndërmjet institucionit përgjegjës me subjektin, që ka në pronësi ambientin tek Pallati me Shigjeta, në Tiranë, ku aktualisht ushtron funksionet e saj, Aleat sh.p.k. për Njësinë Bashkiake nr. 6 dhe 7;

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesja S. L., një përfaqësues i Bashkisë Tiranë<sup>5</sup>, dy përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, njëri prej të cilëve ishte edhe Znj. R. V., Zv/Ministër i këtij dikasteri, si dhe përfaqësuesi i Aleat sh.p.k.<sup>6</sup>

Ankuesja S. L. parashtrori pretendimet e saj për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Znj. S. L. u shpreh se përvoja e saj, në lidhje me aplikimin e saj për pasaportë, pranë zyrës së Aleat shpk, që mbulonte Njësinë Bashkiake nr. 6 dhe 7, ishte jo e mirë. Cilësia e aparaturave të Aleat sh.p.k. është jo e mirë, si dhe komunikimi njerëzor i punonjësës, që mbante vulën e Bashkisë, gjithashtu linte shumë për të dëshiruar. Hyrja për në zyrën e Aleat sh.p.k. nuk kishte rampë, trotuari ishte i lartë dhe nuk kishte vende për të parkuar automjetet. Ajo u shpreh se gjatë aplikimit për pasaportë kishte rradhë dhe asaj nuk i ishte dhënë përparësi, pavarësisht kushteve në të cilat ndodhej. Znj. S. L. u shpreh se gjatë aplikimit i janë kapur duart, pa i kërkuar paraprakisht leje, për të marrë shenjat e gishtërinjve. Ajo u shpreh se rasti i saj nuk është rast i izoluar, pasi situata të ngjashme, ku evidentohen të njëjtat problematika, ndodhin edhe në qendra të tjera të Aleat sh.p.k.

Në vijim, fjala iu dha përfaqësueses së Aleat sh.p.k., që shprehu keqardhjen për situatën e krijuar. Ajo u shpreh se Aleat sh.p.k. merr në përdorim ambientet, në bazë të një Kontrate Konçesioni. Në bazë të kësaj Kontrate Konçesioni, Ministria e Brendshme gjen ambiente të përshtatshme për Aleat sh.p.k. Për Njësitë 6 dhe 7 është caktuar dhe është vënë në dispozicion një ambient tek Pallati me Shigjeta. Ajo u shpreh se ngushtësia e këtij ambienti nuk varej nga Aleat sh.p.k., si dhe theksoi faktin se individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë mund të ri-aplikonin për pasaportë ose kartë identiteti në çdo qendër të Aleat sh.p.k., pavarësisht njësisë bashkiake, së cilës i përkisnin. Lidhur me marrjen e shenjave të gishtërinjve të ankueses, përfaqësuesja e Aleat sh.p.k. u shpreh se gjurmët e gishtërinjve janë të domosdoshëm për të

<sup>5</sup> Mbështetur në Autorizimin nr. 3297/3, datë 17.09.2019, e Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

<sup>6</sup> Mbështetur në Autorizimin e datës 13.09.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Aleat sh.p.k.

lëshuar dokumentin identifikues. Ajo u shpreh se punonjësi mund të ketë këmbëngulur për marrjen e tyre, në mënyrë që Znj. S. L. të mos ishte e detyruar të shkonte në një qendër tjetër, për të përsëritur aplikimin.

Në vijim, fjalën e mori Zëvendësministrja e Brendshme, znj. R. V., e cila sqaroi se Ministria e Brendshme është autoriteti kontraktor me Aleat sh.p.k.. Lidhur me çështjen e ambienteve, ku ushtron aktivitetin e tij Aleat sh.p.k., znj. R. V. u shpreh se ato ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë është vendosur nëpërmjet një marrëveshjeje jo zyrtare<sup>7</sup>, që ambientet ku do të ushtrojnë funksionet e tij Aleat sh.p.k. do të sigurohen nga ana e njësitë e qeverisjes vendore dhe në rastin konkret, nga ana e Bashkisë Tiranë. Ministria e Brendshme ka në administrim regjistrin elektronik të të dhënave të gjendjes civile, ndërkohë që shërbimi i gjendjes civile ushtrohet nga qeverisja vendore. Kjo ka qenë edhe pika kyçe e lidhjes ndërmjet dy institucioneve. Ka qenë kërkesë e vetë Ministrisë të Brendshme që ambientet, ku ushtron veprimtarinë e tij Aleat sh.p.k., të jenë në katet e para. Në rastin konkret, ambienti pranë Pallatit me Shigjeta, ku ushtron funksionet e tij, Aleat sh.p.k. për Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7, është marrë me qera nga Bashkia Tiranë. Znj. R. V. u shpreh se situata aktuale e zyrave, ku ushtron funksionet e tij Aleat sh.p.k. është përmirësuar ndjeshëm. Pranë çdo njësie ka vendqendrimet për individët më aftësi të kufizuara dhe zyrat kane disa poste. Ajo u shpreh se ka akërkuar nga ana e Kryetarëve të njësive vendore të sigurojnë ambiente dinjitoze për Aleat sh.p.k. Për njësinë bashkiake nr. 6, zyra e Aleat sh.p.k. është hapur brenda ambienteve të ADISA-s në Kombinat. Ndër të tjera, Zv/Ministrja e Brendshme theksoi faktin se çdo individ mund të ri-aplikojë për pasaportë dhe kartë identiteti pranë çdo zyre të Aleat sh.p.k. pavarësisht faktit nëse ndodhet pranë Njësisë Bashkiake respektive. Informacioni mbi një fakt të tillë është dhënë në mediat televizive dhe në këtë proces ka qenë e përfshirë dhe e ka ndjekur nga afër edhe vetë Znj. R. V. Zyra të tjera, ku Aleat sh.p.k. ushtron funksionet e tij, kanë hapësira dhe përshtatshmëri për individët me aftësi të kufizuara, sikurse ka edhe ambiente, të cilat kanë nevojë për pajisjen me rampa, për të siguruar aksesueshmërinë fizike të individëve më aftësi të kufizuara.

Më pas, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë u shpreh se në ambientet ku aktualisht ushtron aktivitetin e tij Aleat sh.p.k., për njësinë 6 dhe 7 Tiranë, nuk ka rampë dhe nuk mund të ketë, për shkak të strukturës së kësaj ndërtese. Ky ambient është marrë me qera nga ana e Bashkisë Tiranë, e cila ka marrë përsipër sigurimin e tyre. Ai sqaroi se pothuajse të gjithë zyrat, ku ushtron funksionet e tij Aleat sh.p.k., janë të aksesueshme fizikisht nga individët me aftësi të kufizuara, përveç zyrës për të cilën bëhet fjalë në rastin konkret. Përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë u shpreh se ky institucion ka lidhur një kontratë, e cila ka një shtojcë që ka afat deri në fund të vitit 2019. Ambienti, ku ushtron funksionet e tij Aleat sh.p.k. për Njësitë 6 dhe 7 është i përkohshëm deri në

---

<sup>7</sup> Gentlemen Agreement – Marrëveshje informale dhe juridikisht jo-detyruese midis dy ose më shumë palëve;

31 dhjetor 2019. Në vitin 2020 do të merren ambinete të tjera, të cilat do të kenë përshtatshmëri fizike për individët me aftësi të kufizuara.

Znj. S. L. u shpreh se ajo nuk kishte marrë asnjë informacion se mund të riaplikonte për pasaportë në një zyrë tjetër të Aleat sh.p.k., e cila mund të kishte përshtatshmëri fizike për individët me aftësi të kufizuara.

Në vijim, Komisioneri kërkoi informacion nga ana e Aleat sh.p.k. duke drejtuar pyetjet e mëposhtëme?

1. A ka Aleat sh.p.k. një manual për përdorimin e pajisjeve të posaçme apo dispozita të veçanta për individët me aftësi të kufizuara?
2. A ka patur Aleat sh.p.k. raste/snjalizime të tjera për ankesa të individëve me aftësi të kufizuara, sikurse rasti i Znj. S. L.?
3. Kur Aleat sh.p.k. ushtron funksionet e tij në ambientet përkatëse, a e ka ngritur ndonjëherë problemin e aksesueshmërisë së individëve me aftësi të kufizuara pranë institucioneve përgjegjëse?
4. Si shpjegohet që gjatë inspektimit të kryer pranë Zyrës së Aleat sh.p.k. nuk ka patur punonjës të autorizuar për të dhënë informacion për inspektorët e KMD-së?

Për sa më sipër, përfaqësuesja e Aleat sh.p.k. u sqaroi se ka vënë në dispozicion të KMD-së një dokument, ku shpjegohet procedura e marrjes së gjurmëve të gishtërinjve. Në këtë manual parashikohen edhe rastet kur aplikantët kanë dëmtime apo amputime të gishtërinjve. Ajo u shpreh se ishte hera e parë që Aleat sh.p.k. kishte kontakt me ankesa të kësaj natyre, por gjithësesi u shpreh se operatorët kanë reflektuar nevojën e një përmirësimi. Lidhur me pjesën tjetër të informacionit, përfaqësuesja e Aleat sh.p.k. sqaroi se do të vihej në dispozicion në vijim të seancës dëgjimore.

Komisioneri kërkoi informacion edhe nga Ministria e Brendshme, i cili konsistonte në disa çështje, që kishin të bënin me shpërndarjen e informacionit, sipas së cilit aplikantët mund të riaplikonin pranë çdo zyre të Aleat sh.p.k. për karta identiteti apo pasaporta. Nëse në rastin konkret, ankuesja do të kishte patur këtë informacion, situata konkrete do të shmangej.

Lidhur me Kontratën e Konçesionit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Aleat sh.p.k. u kërkua informacion, nëse kjo kontratë kishte parashikime apo ndonjë aneks të veçantë mbi aksesueshmërinë e individëve me aftësi të kufizuara.

Komisioneri kërkoi gjithashtu informacion edhe mbi mënyrën se si monitorohej nga ana e Ministrisë së Brendshme, shërbimi i Aleat sh.p.k. ndaj aplikantëve.

Komisioneri kërkoi informacion të saktë lidhur me numrin e zyrave të Aleat sh.p.k., në të gjithë Republikën e Shqipërisë, ku të evidentoheshin se sa prej tyre plotësonin kriterin e



aksesueshmërisë fizike për individët me aftësi të kufizuar. Komisioneri kërkoi gjithashtu që informacioni të shoqërohej edhe një plan konkret masash.

Përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë u shpreh se do të dërgonte foto të zyrave të Aleat sh.p.k., në Tiranë.

Në përfundim të seancës dëgjimore u ra dakord ndërmjet palëve pjesëmarrëse dhe KMD-së, që informacioni i kërkuar do të përcillet në adresë të tij, në vijim të kësaj seance.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, në datën 03.10.2019, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë dërgoi nëpërmjet e-mailit zyrtar, foto të zyrave të Aleat sh.p.k. në qytetin e Tiranës.
2. Në datën 04.10.2019, Komisioneri i bën kujtesë Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet e-mailit zyrtar, për të dërguar informacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore. Ministria e Brendshme nuk dërgoi përgjigje në adresë të Komisionerit.
3. Në datën 15.11.2019, Komisioneri iu drejtua sërish nëpërmjet e-mailit zyrtar, Ministrisë së Brendshme, ku i kërkohet të depozitohet informacioni i kërkuar brenda datës 22.11.2019.
4. Në vijim, Komisioneri iu drejtua Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet shkresës nr. 1791, datë 22.11.2019, ku i kërkohet të dërgohet informacion, brenda datës 27.11.2019, mbi çështjet e mëposhtme:
  - Kopje të Kontratës Konçesionare (të mëparshme dhe të rinovuar) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Aleat sh.p.k. për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike;
  - Informacion nëse Kontrata Konçesionare, përmban ndonjë Aneks të Posaçëm, i cili të përmbajë parashikime për individët me aftësi të kufizuar.
  - Cili është detyrimi i subjektit të kontraktuar, lidhur me krijimin e kushteve për aksesueshmëri fizike për individët me aftësi të kufizuar?
  - Informacion nëse Aleat sh.p.k. ka ngritur zyrtarisht shqetësimin, pranë Ministrisë së Brendshme, lidhur me mungesën e aksesueshmërisë fizike, në qendrat ku ai ushtron funksionet e tij. Nëse po, janë kërkuar të dërgohen kopje të korrespondencave përkatëse.
  - Kopje e aktit administrativ, ku parashikohet që shtetasit shqiptarë mund të paraqiten për riaplikim për pasaportë, apo kartë identiteti në çdo qendër të Aleat sh.p.k.;
  - Mënyra se si janë informuar shtetasit shqiptarë, lidhur me parashikimin e mësipërm;
  - Mënyra se si është monitoruar veprimtaria e Aleat sh.p.k., në lidhje me zbatimin e Kontratës Konçesionare, që nga momenti i nënshkrimit të saj e në vijim;

- Cilat janë konstatimet e Ministrisë së Brendshme, lidhur me cilësinë e pajisjeve të përdorura nga Aleat sh.p.k. për prodhimin e pasaportave dhe kartave të identitetit?
- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të zyrave, ku ushtron veprimtarinë e tij, Aleat sh.p.k. dhe sa prej tyre nuk plotësojnë kriterin e aksesueshmërisë fizike për individët me aftësi të kufizuara;
- Cili është plani i masave të Ministrisë së Brendshme, për të siguruar aksesueshmëri fizike për individët me aftësi të kufizuara, në të gjitha ambientet/zyrat, ku ushtron funksionet e tij Aleat sh.p.k.

5. Ministria e Brendshme nuk dërgoi përgjigje brenda afatit të përcaktuar nga Komisioneri në shkresën e mësipërme. Në këto kushte, Komisioneri procedoi në mungesë të këtij informacioni.

6. Aleat sh.p.k. gjithashtu nuk e dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri gjatë seancës dëgjimore, edhe pasi iu dërgua njoftim me e-mail<sup>8</sup>, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme.

#### **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 73, datë 25.06.2019, së Znj. S. L., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

##### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Në ankesën nr. 73, datë 25.06.2019, e Znj. S. L., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Aleat sh.p.k. pranë Njesisë Bashkiake nr. 6 dhe nr. 7, në Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë.

Referuar Librezës së Identitetit “Për Përfituesit e Statusit të Invalidit paraplegjik – Tetraplegjik”, nr. 00078<sup>9</sup>, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, Znj. S. L. i përket kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë. Në cilësinë e individit me aftësi të kufizuara, Znj. S. L. ankohet ndaj subjekteve të sipërpërmendura, pasi këta subjekte nuk ofrojnë aksesueshmërinë fizike të kësaj kategorie individësh, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

<sup>8</sup> Në mungesë të një adrese e-maili, Aleat sh.p.k. iu dërgua njoftim për dërgim informacioni, nëpërmjet personave të kontaktit pranë Ministrisë së Brendshme;

<sup>9</sup> Librezë e Identitetit “Për Përfituesit e Statusit të Invalidit paraplegjik – Tetraplegjik”, nr. 00078, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror është e vlefshme nga data 19.02.2019 – 19.02.2022.

- I. Pretendimi i parë për diskriminim i Znj. S. L. mbështetet në faktin se pranë zyrës së Aleat sh.p.k., ku qytetarët e Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe 7, aplikojnë dhe riaplikojnë për karta identiteti dhe pasaporta, nuk sigurohet aksesueshmëria fizike e individëve me aftësi të kufizuara. Në kushtet kur, Znj. S. L. i përket kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në mungesë të rampës, e ka patur të pamundur për të patur vetë e në mënyrë të pavarur, akses fizik në zyrën e Aleat sh.p.k., zyrë kjo e ndodhur tek Rruga e Kavajës, Pallati me Shigjeta. Ajo është ndihmuar nga individë të tjerë, si dhe nga babai i saj, për të patur akses fizik në këtë zyrë.

Nga verifikimet e drejtpërdrejta të kryera gjatë hetimit administrativ të ankesës nr. 73, datë 25.06.2019, Komisioneri konstatoi se realisht zyra e Aleat sh.p.k., për Njësinë Bashkiake nr. 6 dhe 7, nuk ishte e pajisur me rampë, nëpërmjet së cilës mund të sigurohej aksesueshmëria fizike e individëve me aftësi të kufizuara.

Në prapësimet e Aleat sh.p.k. drejtuar KMD-së theksohej fakti se kjo shoqëri nuk kishte asnjë përgjegjësi, lidhur me mosplotësimin e kriterit të aksesueshmërisë fizike për individët me aftësi të kufizuara në zyrat, ku kryhen aplikime për pasaporta dhe karta identiteti, pasi përgjegjësia për sa më sipër ishte e institucioneve shqiptare, me të cilat ishte lidhur Kontrata e Konçesionit. Aleat sh.p.k. nuk i siguronte vetë ambiente ku do të ushtronte aktivitetin e tij, por ishte pala shqiptare që i mundësonte këto zyra, pranë njësive bashkiake respektive ose në ambiente të tjera të marra me qera.

Për sa më sipër, rezulton se në bazë të ligjit nr. 9972, datë 28.07.2008 “*Për ratifikimin e “Kontratës Konçesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të Sagem Securite të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”*”, ndërmjet shtetit shqiptar të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme dhe Grupimit të Sagem Securite të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve është lidhur një Kontratë Konçesionare, e cila në vitet në vijim është rinovuar. Sikurse rezultoi edhe gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar nga Komisioneri, përgjegjësia për sigurimin e ambienteve ku Aleat sh.p.k. do të ushtrojë veprimtarinë e tij është e Ministrisë së Brendshme. Ky institucion ka *de jure* përgjegjësinë për sigurimin dhe ofrimin e zyrave ku do të kryhen aplikimet për pasaporta dhe karta identiteti, ndërkohë që *de facto* një detyrë e tillë kryhet nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe në rastin konkret nga ana e Bashkisë Tiranë. Gjatë hetimit administrativ të ankesës së Znj. S. L. rezultoi se edhe pse ligjërisht dhe zyrtarisht nuk ekziston asnjë Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Njësive të Qeverisjes Vendore, këto të fundit kanë marrë përsipër të sigurojnë ambiente për funksionimin e zyrave të Aleat sh.p.k. pranë zyrave vendore të gjendjes civile, ose në pamundësi lidhin kontrata qeraje, ndërmjet subjekteve të ndryshme, ku njësitë e qeverisjes vendore ndodhen në pozicionin e përfituesit, për të siguruar ambiente për funksionimin e zyrave të Aleat sh.p.k.

Në rastin konkret, rezulton se Bashkia Tiranë ndodhet në pozicionin e Përfituesit në Kontratën e Qirasë – Huapërdorje Tre Palëshe nr. 4972/1, datë 30.01.2019, të lidhur ndërmjet Z. N.S., shtetas shqiptar, zotërues i pronësisë me adresë “Rruga e Kavajës”, Hyrja 6, Tiranë, i cili ndodhet në pozicionin e Qiradhënësit dhe Shoqërisë “Dodaj” sh.p.k., përfaqësuar nga z. A. D., në cilësinë e Administratorit, i ndodhur në pozicionin e “Qiramarrësit” apo “Dhuruesit”.

Në Kontratën e Qirasë – Huapërdorje Tre Palëshe nr. 4972/1, datë 30.01.2019 citohet shprehimisht: “A) Bashkia Tiranë, në kuadër të zbatimit të projektit, për ofrimin, ndër të tjera, të shërbimeve të ndryshme si të regjistrimit, përgatitjes, aktivizimit dhe shpërndarjes së kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike (“Shërbime”) për të gjithë qytetarët e regjistruar pranë Njësive Administrative të cilat administrohen nga Bashkia Tiranë, ka marrë përsipër sigurimin e ambienteve të përshtatshme për dhënie të shërbimeve në bashkëpunim me shoqërinë e ngarkuar sipas rregullave ALEAT sh.p.k. (“ALEAT”)

B) Qiramarrësi, në cilësinë e dhuruesit në favor të Përfituesit/Bashkisë Tiranë, me synim përmirësimin e kushteve dhe rritjes në cilësisë së shërbimeve ofruar në kryeqytet, ka shprehur dëshirën për të kontribuar duke marrë përsipër shpenzimet e qirasë për ambientet në të cilat do të ofrohen Shërbimet pranë Njesisë Administrative Nr. 6 dhe 7;

C).....

D).....

E) Qiradhënësi synon t'i japë me qira Pronën Qiramarrësit/Dhuruesit dhe Qiramarrësit/Dhuruesi ka për qëllim të marrë me qira Pronën nga Qiradhënësi, për t'ia vënë në dispozicion të Përfituesit, për t'u përdorur si Zyrë për ofrimin e Shërbimeve pranë Njësive Administrative Nr. 6 & 7 (“Zyra 6 dhe 7) gjatë gjithë afatit të kësaj kontrate, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj kontrate.”

Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë theksoi faktin se teknikisht ishte e pamundur ngritja e një rampe për të siguruar aksesueshmërinë fizike të individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në zyrën e Aleat sh.p.k. që mbulon Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7, Tiranë. Por në kushtet kur, në bazë të Shtojcës së Kontratës nr. prot. 29717, datë 30.01.2019, të lidhur ndërmjet Z. N.S., shtetas shqiptar, zotërues i pronësisë me adresë “Rruga e Kavajës”, Hyrja 6, Tiranë, në cilësinë e Qiradhënësit dhe Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. E. V., Kryetar, në pozicionin e Qiramarrësit, afati i kësaj kontrate është deri në datën 31.12.2019, në vijim do të proçedohej për ndryshimin e zyrës së Aleat sh.p.k. në një ambient ku të sigurohet lehtësisht aksesueshmëria fizike e individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, si dhe e gjithë kategorisë së individëve me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht sa më sipër, mbështetur në Kontratën Konçesionare të sipërpërmendur, është Ministria e Brendshme që ka përgjegjësinë ligjore, lidhur me mosplotësimin e kriterit të aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuara, në ambientet e Aleat sh.p.k., që mbulojnë njësitë bashkiake nr. 6 dhe 7, Tiranë.

Përveç sa më sipër, ky institucion mban edhe përgjegjësinë kryesore për mos shpërndarjen e duhur të informacionit, në bazë të së cilit të gjithë individët mund të riaplikojnë për dokumente identifikuese pranë çdo zyrë të Aleat sh.p.k., pavarësisht njësisë bashkiake, së cilës i përkasin. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se Znj. S. L. nuk ishte e informuar mbi sa më sipër. Edhe nga vetë punonjësit e Aleat sh.p.k. që punonin në zyrën e kësaj shoqërie, që mbulonte Njësitë bashkiake 6 dhe 7, nuk e kishin bërë me dije ankuesen mbi një fakt të tillë. Nëse, Znj. S. L. do të kishte patur një informacion të tillë, ajo do të ishte paraqitur për të riaplikuar për pasaportë pranë një tjetër zyre të kësaj shoqërie, që ofronte të gjitha kushtet për aksesueshmëri fizike. Mungesa e informacionit të duhur shkaktoi situatën, e cila u bë objekt ankese pranë KMD-së.

Pas seancës dëgjimore, KMD kërkoi zyrtarisht në mënyrë të përsëritur nga ana e Ministrisë së Brendshme, informacion lidhur me disa çështje të ngritura për diskutim në këtë seancë, për të cilat ishte rënë dakord, që informacioni do të dërgohej në vijim. Ministria e Brendshme nuk e dërgoi informacionin e kërkuar nga KMD edhe pse në referencë të nenit 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)<sup>10</sup>, është saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret këtij institucioni.

Njëkohësisht, pas seancës dëgjimore të zhvilluar mbi ankesën e Znj. S. L., KMD kërkoi informacion vijues edhe nga Aleat sh.p.k., ku një ndër çështjet kryesore konsistonte, nëse kjo shoqëri e kishte ngritur shqetësimin e saj tek institucioni përgjegjës shqiptar në bazë të Kontratës Konçesionare, për mos plotësimin e kriterit të aksesueshmërisë fizike për individët me aftësi të kufizuara, në zyrën që mbulon Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7. Në vijim të seancës dëgjimore, Aleat sh.p.k. nuk dërgoi asnjë informacion, as mbi këtë çështje dhe as mbi çështjet e tjera, për të cilat u ra dakord, që informacioni do të dërgohej në adresë të Komisionerit. Në cilësinë e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa, Aleat sh.p.k. ka patur detyrimin ligjor, si dhe barrën e provës për të provuar të kundërtën e asaj që pretendohet në ankesë, sikurse edhe t’i përgjigjej administrativisht me informacionin e dukur, Komisionerit.

---

<sup>10</sup> Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri krijon bindjen e arsyeshme se Znj. S. L. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Aleat sh.p.k.

- II.** Pretendimi i dytë për diskriminim i Znj. S. L., mbështetet në faktin se pranë zyrës së Aleat sh.p.k., që mbulon Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7, gjatë procedurës së marrjes së shenjave të gishtërinjve, ajo është sforcuar nga operatorët e kësaj shoqërie, duke shkelur integritetin e saj, fizik. Ankuesja pretendon se operatorët e Aleat sh.p.k. janë të patrajnuar dhe të papërgatitur, për të marrë shenjat e gishtërinjve të personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë korrespondencës zyrtare me KMD, Aleat sh.p.k. ka theksuar faktin se marrja e saktë e gjurmëve të gishtërinjve është tepër e rëndësishme për të prodhuar kartat e identitetit apo pasaportat elektronike. Sforcimi, së cilit Znj. S. L. pretendon se i është nënshtruar, është konsideruar si një përpjekje e operatorëve të kësaj shoqërie, për të mos e detyruar ankuesen të përsërisë procedurën e marrjes së shenjave të gishtërinjve, pranë një tjetër qendre të Aleat sh.p.k.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri kërkoi nga kjo shoqëri, Manualin e miratuar, mbi bazën e së cilit, operatorët e Aleat sh.p.k. mbështeteshin për të kryer procedurën e marrjes së shenjave të gishtërinjve, gjatë aplikimit për kartë identiteti apo pasaportë elektronike.

Pas analizimit të këtij Manuali, Komisioneri konstatoi se ky akt përmbante në mënyrë të detajuar procedurat për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve dhe kryerjen e procesit të reregjistrimit në rastet e kapjes së pamjaftueshme të tyre. Referuar parashikimeve në këtë dokument rezulton se sistemi i përdorur nga Aleat sh.p.k. ofron 3 raste të marrjes së shenjave të gishtërinjve, përkatësisht kur, gishtërinjtë e aplikantit janë të amputuar (seksioni c), të fashuar (Seksioni d) ose të dëmtuar (Seksioni e). Rasti i dytë, i parashikuar në Seksionin d) nuk është i autorizuar për aplikim nga Shoqëria.

Në rastin e gishtërinjve të dëmtuar, përfshihen rastet kur, duart dhe gishtërinjtë e aplikantit janë të dëmtuara nga punë të ndryshme dhe/ose sëmundje. Referuar këtij parashikimi, rezulton se rekomandimi i parë për aplikantit është që të aplikojë pas shërimit të gishtërinjve. Këtu, përcaktohet detyrimi i operatorit për t'i komunikuar aplikantit mbi mungesën e cilësisë dhe mundësinë për t'u rikthyer e për të aplikuar për dokumente identifikuese, pas përmirësimit të cilësisë së shenjave të gishtërinjve, nëpërmjet përdorimit të kremit, larjes etj. Referuar këtij Seksioni rezulton se në këtë kategori, bëjnë pjesë edhe qytetarë të moshuar, qytetarë të sëmurë, punëtorët në fushën e ndërtimit etj., si dhe fëmijët e vegjël në moshën 6 vjeç.

Gjatë analizimit të këtij dokumenti të dërguar nga Aleat sh.p.k., Komisioneri konstatoi se në asnjë Seksion të tij nuk janë të përfshirë procedurat dhe mënyrat, për marrjen e shenjave të

gishtërinjve për individët tetraplegjikë, duart dhe gishtërinjtë, e të cilëve janë jofunksionalë dhe që nuk mund të përdoren apo të drejtohen nga vetë këta individë. Këta individë nuk përbëjnë asnjë nga rastet e përfshira në Seksionin e), pasi në dokumentin e elaboruar nga Aleat sh.p.k. nuk rezulton të jenë përfshirë individët me aftësi të kufizuar. Në këtë seksion, përmenden individët e sëmurë, pa dhënë specifikime të mëtejshme.

Komisioneri çmon se në kushtet kur, Manuali i kësaj shoqërie nuk përmban asnjë specifikim mbi procedurat që duhen ndjekur nga ana e saj, për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve për individët paraplegjikë, në asnjë rast operatorët e kësaj shoqërie nuk mund të jenë të aftë për të trajtuar dhe për të proçeduar në proçesin e marrjes së shenjave të gishtërinjve për këtë kategori individësh.

Në këtë kontekst, në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri krijon bindjen e arsyeshme se Znj. S. L. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Aleat sh.p.k.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën nr. 73, datë 25.06.2019, e Znj. S. L., pretendohet diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Aleat sh.p.k. pranë Njësisë Bashkiake nr. 6 dhe nr. 7, në Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë.

*“Aftësia e kufizuar” është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e palës ankuese për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se “aftësia e kufizuar” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme të depozituara nga ankuesja, që e justifikojnë si të tillë.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.**

Znj. S. L. bën pjesë në kategorinë e invalidëve para dhe tetraplegjikë, e cila është një kategori e grupit të personave me aftësi të kufizuara, që gëzon një sërë të drejtash në bazë të legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>11</sup> në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Njëkohësisht mbështetur në Komentin e Përgjithshëm të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, aksesueshmëria është konsideruar si një faktor themelor për zbatimin e Konventës “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”. Duke qenë se aksesueshmëria përbën parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shoqëri, mohimi i aksesit në mjedis, transport, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, në shërbimet e hapura për publikun duhet të shihet gjithmonë si diskriminim, sipas këtij Komenti.

Nën frymën e Konventës së sipërpërmendur, ligjvënësi ka miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, që mbrojnë shprehimisht të drejtën e individëve me aftësi të kufizuar për aksesueshmëri fizike e më gjerë, në fusha të ndryshme.

Për sa më sipër, legjislacioni shqiptar siguron mbrojtje të të drejtave të kategorisë së individëve paralegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët janë pjesë e grupit të individëve me aftësi të kufizuara. Ligji nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar) parashikon detyrimin e shtetit për të krijuar kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Sipas nenit 2, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar), me “Paraplegjik” nënkuptohet çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme, ndërsa “Tetraplegjik” nënkuptohet çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor

---

<sup>11</sup>Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.



të Caktimit të Aftësisë për Punë. Në këtë kontekst, rezulton se aftësia e kufizuar e individëve, që i përkasin kësaj kategorie është e tillë, që kërkon në mënyrë të domosdoshme ofrimin e lehtësive për të patur aksesueshmëri fizike në të gjitha ambientet ku ofrohen shërbime publike e më gjerë. Pikërisht, për këtë arsye, ligjvënësi ka ofruar një sërë parashikimesh në akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore që parashikojnë detyrimin e institucioneve përgjegjëgjese dhe subjekteve private për të mundësuar një gjë të tillë.

Neni 4, i ligjit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht: *“Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes”*.

Ndërkohë që, ligji nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”* përmban parashikime të rëndësishme në drejtim të sigurimit të aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuar. Neni 4, i këtij ligji përcakton parimet bazë mbi të cilat ky ligj mbështetet. Dy prej parimeve bazë të tij janë përkatësisht parimi i mosdiskriminimit dhe ai i aksesueshmërisë së individëve me aftësi të kufizuar. Ligji nr. 93/2014 ka për detyrë që të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë, si dhe të garantojë gjithashtu aksesueshmërinë nëpërmjet mënjanimin të pengesave të të gjitha llojeve.

Në referencë të nenit 3, të ligjit nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*, “aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve. Sipas këtij ligji, ndër të tjera, me “pengesa” nënkuptohen edhe pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike.

Parashikime të mëtejshme përmban ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

*Persona me aftësi të kufizuara*, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

*Jetesa e pavarur*, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe sigurimi i aksesit në shërbimet shoqërore. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

Me qëllimin nxitjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, Qeveria shqiptare ka miratuar me Vendimin nr. 483, datë 29.06.2016, e Këshillit të Ministrave “*Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020*”. Ky plan parashikon disa lloje aktivitësh në disa fusha, njëra prej të cilave është edhe sigurimi i aksesueshmërisë fizike dhe atë të informacionit për individët me aftësi të kufizuara.

Në këtë kontekst vlen të përmendet që edhe Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”, i cili përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohej pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi do të konsiderohen pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; etj.

Në pikën 4, të këtij Vendimi parashikohet: “*Vendimi i sipërpërmendur e shtrin zbatimin e tij mbi: a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara; b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët; c) mjetet e transportit publik; ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.*”

Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se neni 20, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>12</sup> siguron mbrojtje nga diskriminimi, në fushën e të mirave e shërbimeve, për shkaqet e parashikura në nenin 1 të këtij ligji, ku bën pjesë edhe aftësia e kufizuar.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës së Znj. S. L., Komisioneri konstatoi se në zyrën e Aleat sh.p.k., që mbulon shërbimet publike për aplikim për dokumente identifikuese të shtetasve shqiptarë, për Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7, mungon aksesueshmëria fizike për individët me aftësi të kufizuar. Sikurse u vu re më sipër, sigurimi i aksesueshmërisë fizike për këtë kategori individësh është detyrim ligjor në kuadër konventash ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ashtu sikurse edhe nga legjislacioni i brendshëm shqiptar.

Përveç sa më sipër, Komisioneri çmoi gjithashtu se mungesa e informacionit mbi faktin, se qytetarët mund të riaplikojnë për karta identiteti dhe pasaporta elektronike pranë çdo zyre të Aleat sh.p.k., ka qenë gjithashtu një çështje për t’u patur nën vëmendje. Nëse Znj. S. L. do të ishte patur një informacion të tillë, do të riaplikonte pranë një zyrë tjetër të Aleat sh.p.k., ku nuk do të mungonte aksesueshmëria fizike për individët me aftësi të kufizuar. Ky informacion mund t’u jepej të gjithë shtetasve shqiptarë nëpërmjet afishimeve pranë zyrave të gjendjes civile, apo në shumë mënyra të tjera praktike dhe efikase, në mënyrë që situata të tilla të shmangen.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesja S. L. është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

---

<sup>12</sup> Neni 20 i LMD parashikon shprehimisht: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t’u përdorur nga publiku; b) mundësi për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; c) kontributin dhe mundësinë për të përfutur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun; ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor; d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim; dh) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera; e) shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim; ë) lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim; f) lehtësi për transport ose udhëtim; g) shërbimet e profesioneve të lira. 3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitim të këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuara ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet. 4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohen asnjë arsye si shkak i refuzimit.”

## PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (të ndryshuar), ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 4, 6 e nenin 20, të ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, neneve 2 dhe 4 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar), Vendimit nr. 1074, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, Vendimit nr. 483, datë 29.06.2016, të Këshillit të Ministrave “*Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020*”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të Znj. S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Ministria e Brendshme.
2. Konstatimin e diskriminimit të Znj. S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Aleat sh.p.k.
3. Konstatimin e mosdiskriminimit të Znj. S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Tiranë.
4. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, e individëve me aftësi të kufizuara në tërësi, në zyrën e Aleat sh.p.k. që mbulon Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7, Tiranë.
5. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të shpërndarë në publik informacionin e duhur, me mjete dhe mënyra efikase, lidhur me mundësitë e shtetasve shqiptarë për të riaplikuar për dokumentet identifikuese, pranë çdo zyrë të Aleat sh.p.k. .

6. Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Aleat sh.p.k., për të kryer parashikimet përkatëse në Manualin respektiv, lidhur me procedurat, që duhen ndjekur për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve, për individët me aftësi të kufizuara.
7. Rekomandohet që, Ministria e Brendshme dhe Aleat sh.p.k., të garantojnë aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në të gjithat pikat e territorit të Republikës së Shqipërisë, ku ofrojnë shërbimin për aplikimin dhe riaplikimin e kartave të identitetit dhe pasaportave.
8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Ministria e Brendshme dhe Aleat sh.p.k., të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij Vendimi.
9. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, moszbatimi i këtij Vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
10. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

Fusha - te mira e shërbime  
Shkak – aftësi e kufizuar